


- Kimia organike është kimia e komponimeve të:
  - Karbonit
  - Sulfurit
  - Oksigjenit
  - Hidrogjenit
- Përcaktimi i përbërjes së një komponimi organik bëhet përmes:
  - Analizës kimike
  - Analizës fizike
  - Sintezës
  - Djegies
- Nëse një substancë e ngjyros letrën e lakmusit prej të kuqes në të kaltërt atëherë themi se ajo substancë ka veti:
  - Acidike
  - Bazike
  - Amfotere
  - Neutrale
- Sa elektrone valencore ka atomi i karbonit në strukturën e tij? ( $Z=6$ )
  - 6 elektrone valencore
  - 12 elektrone valencore
  - 4 elektrone valencore
  - 2 elektrone valencore
- Si quhet lidhja që formohet me çiftëzim të elektroneve?
  - Lidhje metalike
  - Nuk formohet lidhje
  - Lidhje jonike
  - Lidhje kovalente
- Cili nga komponimet e mëposhtme bënë pjesë në komponime organike aciklike (alifatike)?
  - Cikloheksani
  - Metani
  - Benzeni
  - Piridina
- Cili nga komponimet e mëposhtme është hidrokarbur aromatik?
  - Metani
  - Benzeni
  - Etini
  - Propeni
- Komponimet e karbonit që përmbajnë lidhje trefishe mes atomeve të karbonit quhen:
  - Alkane
  - Alkine
  - Alkene
  - Metale

- 2 mole të hidrogjenit në kushte standarde zënë vëllim prej :
  - 11.2 L
  - 22.4 L
  - 4.48 L
  - 44.8 L
- Metil-2-propani është izomer i:
  - Propanit
  - Metanit
  - Butanit
  - Heksanit
- Në cilën periudë dhe në cilin grup të Sistemit Periodik gjendet natriumi ( ${}_{11}\text{Na}$ ) :
  - Perioda 3 , grupi 2
  - Perioda 2 , grupi 1
  - Perioda 1 , grupi 1
  - Perioda 3 , grupi 1


- Në figurën e mëposhtme është paraqitur reaksioni i:



- Adicionimit
- Eliminimit
- Zëvendësimit
- Substituimit

- Sa është densiteti i një blloku kubik metali që ka një masë prej 320 gram dhe një brinjë 2 cm?
  - 120
  - 80
  - 40
  - 30

- Emërtoni hidrokarburin e mëposhtëm duke përdorur nomenklaturën IUPAC.



- Etil-5-metil-3-oktan
- Metil-3,5,5 - oktan
- Dimetil- 3,5 - propil -3 - heksan
- Trimetil-3,5,5-oktan

15. Cili nga alkanet e mëposhtme është në gjendje të lëngët:
- Metani
  - Butani
  - Heksani
  - Propani
16. Cila nga pohimet e mëposhtme është i saktë për Karbonin?
- Karboni mund të formoj vetëm lidhje njëfishe
  - Karboni është elementi me elektronegativitetin më të lartë
  - Karboni është metal
  - Karboni është katërvaleent (tetravalent)
17. Alkanet me varg karbonik të drejtë dhe të degëzuar njihen si:
- Hidrokarbure të pangopura
  - Hidrokarbure alifatike
  - Hidrokarbure aromatike
  - Hidrokarbure stabile
18. Cili nga elementet e mëposhtme ka 5 elektrone valencore në strukturën e tij?
- $^{13}\text{Al}$
  - $^{15}\text{P}$
  - $^{16}\text{S}$
  - $^{17}\text{Cl}$
19. Cili nga hidrokarburet e mëposhtme nuk ka izomerë?
- Butani
  - Heptani
  - Propani
  - Heksani
20. Kur sulfuri rombik nxehet në  $120^\circ\text{C}$  shëndrohet në një lëng më ngjyrë portokalli, kur ky lëng ftohet formohet :
- Sulfuri elementar
  - Sulfuri monoklinik
  - Sulfuri rombik përsëri
  - Sulfuri plastik
21. Diamanti është modifikim alotropik i cilit element?
- Karbonit
  - Bismuthit
  - Bakrit
  - Sulfurit
22. Formula kimike e gjipsit është :
- $\text{CaSO}_4 \times 2\text{H}_2\text{O}$
  - $\text{MgCO}_3$
  - $\text{H}_3\text{PO}_4$
  - $\text{Fe}_2\text{O}_3$
23. Aliazhet janë :
- Përzierje e dy apo më shumë jometaleve
  - Përzierje e metaleve me jometale
  - Përzierje e oksideve
  - Përzierje e dy apo më shumë metaleve në gjendje të shkrirë
24. Gjatë elektrolizës së klorurit të magnezit ( $\text{MgCl}_2$ ) bëhet ndarja e magnezit dhe klorit:
- Magnezi ndahet në anodë , ndërsa klori në katodë
  - Dy elementet ndahen në katodë
  - Magnezi ndahet në katodë , ndërsa klori në anodë
  - Dy elementet ndahen në anodë
25. Formula kimike e gëlqeres së shuar është:
- $\text{CaO}$
  - $\text{Ca}(\text{OH})_2$
  - $\text{MgO}$
  - $\text{Mg}(\text{OH})_2$
26. Sa është numri oksidues i Sn në  $\text{SnO}$ ,  $\text{SnCl}_4$  and  $\text{SnCO}_3$  ?
- +2, +4, +2
  - +2, +4, +3
  - +3, +2, +2
  - +2, +3, +3
27. Kur hekuri I nënshtrohet procesit të ndryshkjes, apo siç njihet ndryshe edhe korrozioni, atëherë formohet:
- Kripërat e hekurit
  - Bazat e hekurit
  - Acidet e hekurit
  - Oksidi I hekurit
28. Sa izomer ka pentani?
- 2
  - 4
  - 3
  - 5
29. Cili nga hidrokarburet e mëposhtme jep reaksion të hidrogjenimit?
- Metani
  - Propani
  - Pentani
  - Buteni
30. Nëse një alkan ka 20 atome hidrogjeni në molekulën e tij, atëherë si e quajmë këtë alkan?
- Heksani
  - Nonani
  - Dekani
  - Heptani

31. Cila nga të mëposhtmet është formula gjenerale e alkeneve?
- A)  $C_nH_{2n-2}$   
 B)  $C_nH_{2n}$   
 C)  $C_nH_{2n+2}$   
 D)  $C_nH_{2n+1}$
32. Cili nga elementet e mëposhtëme përmbanë lidhje trefishe në strukturën e tij? ( $_9F$ ,  $_7N$ ,  $_1H$ ,  $_8O$ )
- A)  $F_2$   
 B)  $N_2$   
 C)  $H_2$   
 D)  $O_2$
33. Sa litra gaz të dioksidit të karbonit ( $CO_2$ ) mund të prodhohen kur 5.6 gram eten digjen plotësisht në kushte standarde?
- A) 33,6  
 B) 11.2  
 C) 8,96  
 D) 2.24
34. Cili nga komponimet e mëposhtme nuk mund të oksidohet nga permanganati I kaliumit ( $KMnO_4$ )?
- A)  $C_3H_6$   
 B)  $C_4H_{10}$   
 C)  $C_2H_4$   
 D)  $C_5H_{10}$
35. Cili është simboli kimik I kallajit?
- A) K  
 B) Ka  
 C) Sn  
 D) Ca
36. Sulfuri është element I grupit të 16 të Sistemit Periodik, i cili bënë pjesë në:
- A) Metale  
 B) Jometale  
 C) Metaloide  
 D) Gazra fisnike
37. Cila nga metodat e mëposhtme përdoret për ndarjen e përzierjes të hekurit dhe sulfurit?
- A) Filtrimit  
 B) Kristalizimit  
 C) Dekantimit  
 D) Ndarja me magnet
38. Cili nga modifikimet alotropike të fosforit ka reaktivitet më të lartë ?
- A) Fosfori I bardhë  
 B) Fosfori I kuq  
 C) Fosfori I zi  
 D) Fosforiti
39. Komponimi i karbonit i cili formon komponim të qëndrueshëm me hemoglobinën , i cili është mjaft helmues, është:
- A)  $CO_2$   
 B)  $NaHCO_3$   
 C)  $H_2CO_3$   
 D) CO
40. Emri i komponimit me formulë kimike  $K_2Cr_2O_7$  është :
- A) Dikromat kaliumi  
 B) Kromat kaliumi  
 C) Oksid I krom- kaliumit  
 D) Kromit kaliumi
41. Cila nga formulat e mëposhtme është e saktë për treoksidin e hekurit (III) ?
- A)  $FeO$   
 B)  $Fe_2O_3$   
 C)  $FeO_3$   
 D)  $Fe_3O_2$
42. Masa atomike e atomit të sulfurit është  $53.29 \times 10^{-24}$  g, llogaritni masën atomike relative të sulfurit:
- A) 32.08  
 B) 16  
 C) 40.05  
 D) 64
43. Shpejtesia e reaksionit paraqet shëndrrimin e reaktantëve në produkte për:
- A) Kohë të caktuar  
 B) Kohë të pacaktuar  
 C) Kohë të padefinuar  
 D) Kohë të përshkruar
44. Uji ngrinë në temperaturë:?
- A) 1 grade  
 B) -100 grade  
 C) 0 grade  
 D) -10 grade
45. Formula e ujit e shënuar në këtë mënyrë  $2H_2O$ , tregon:
- A) Numrin e molekulave  
 B) Numrin e joneve  
 C) Numrin e atomeve  
 D) Numrin e protoneve
46. Sa është numri më I madh I elektroneve në shtresën e dytë?
- A) 2  
 B) 4  
 C) 6  
 D) 8

47. Tretësira e ujit me sheqer është:

- A) Komponim kimik
- B) Tretësirë kimike
- C) Përzierje homogjene
- D) Përzierje heterogjene


48. Substancat të cilat kanë përbërje të njejtë në të gjitha pjesët e tyre quhen:

- A) Përzierje heterogjene
- B) Substanca të përbëra
- C) Substanca të përziera
- D) Substanca të pastërta

49. Cila është formula e komponimit të formuar në mes  $Al^{+3}$  dhe  $O^{-2}$  ?

- A)  $AlO$
- B)  $AlO_3$
- C)  $Al_2O_3$
- D)  $Al_3O_2$

50. Cila nga opsionet e mëposhtme paraqet produktet e reaksionit?



- A)  $CO + H_2$
- B)  $CO_2 + OH$
- C)  $CH_2 + C_2H_6$
- D)  $CO_2 + H_2O$

mac  
MEHMET AKIF  
SCHOOLS